



Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.


Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësit e institucioneve, pjesë e Rrjetit të Koordinatorëve, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi e përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrimin të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Janar, 2023

Ministria e Drejtësisë/Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit analizon arritjet e vitit 2022 dhe prezanton objektivat 2023 - antikorrupsioni

11.01.2023: Ministri i Drejtësisë, Ulsi Manja prezantoi publikisht në një tryezë të hapur për median dhe publikun analizën e veprimtarisë institucionale të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin 2022, referuar fushës së përgjegjësisë që ndjek dhe zbaton. Bashkë-organizimi i Ministerialit të Ballkanit Perëndimor me Bashkimin Evropian, me Ministrinë e Brendshme, si një shprehje e vlerësimit madhor për Tiranën në fushën e drejtësisë, të rendit publik dhe sigurisë, si dhe evidenca konkrete dhe të matshme në luftën kundër korrupsionit, përpos të tjerave ishin informacione të ndara në takimin analizë vjetore të mbajtur për këtë qëllim. Të dhëna dhe statistika që tregojnë rezultate solide në qasjen horizontale antikorrupsion: parandalim – ndëshkim – ndërgjegjësim si dhe masa dhe ndëshkime disiplinore dhe penale, si dhe rekomandime të dhëna ndaj zyrtarëve dhe funksionarëve të shumtë në administratën publike, u ndanë me median dhe publikun. Gjatë vitit 2023, Ministria e Drejtësisë së bashku me Ministrinë e Brendshme do të vijojnë të jenë bashkëudhëtarë në funksion të proceseve institucionale, ku prioritet do të jetë padyshim ecuria pozitive në rrugën e negociatave, përmes kapitujve 23 dhe 24.



Më shumë informacion mund të gjeni në link: https://www.facebook.com/manjaulsi/videos/909288490117529

Samiti për Demokraci; Shqipëria merr angazhime të reja antikorrupsion (cohort) në nivel rajonal dhe global

19.01.2023: Ministria e Drejtësisë merr pjesë aktivisht në të parin forum diskutimi për vitin 2023, në kuadër të angazhimit të Samitit për Demokraci. Në drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë së Bullgarisë, grupi i shteteve të Evropës Lindore në këtë Samit zhvilloi forumin e "Politikave antikorrupsion si një garanci për sigurinë kombëtare, stabilitetin dhe sovranitetin", ku vendet konfirmuan dhe ndanë eksperiencat e tyre në hartimin e politikave antikorrupsion dhe të orientuar nga nismat ndëshkuese. Shqipëria bëri një prezantim të mekanizmave të saj të ndëshkimit antikorrupsion, të organizimit dhe të funksionimit të Rrjetit Kombëtar të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit. Drejtori i Përgjithshëm i Antikorrupsionit z. Demollari prezantoi Rrjetin Kombëtar të Koordinatorëve dhe disa prej të dhënave konkrete të tij të vitit të fundit. Pjesëmarrja antikorrupsion (cohort) përbën një angazhim të ri ndërkombëtar të fushës antikorrupsion, me rol evident ndëshkimin e krimit të korrupsionit në nivelet e larta, zero tolerancë ndaj korrupsionit në administratë, roli i shoqërisë civile në goditjen kundër korrupsionit, etj. Samiti për Demokraci dhe pjesëmarrja në të do të vijohet nga angazhime konkrete të funksionarëve antikorrupsion në evente ndërkombëtare si edhe e hartimin e planit të veprimit kombëtar për zbatim.

Drejtësia dhe antikorrupsioni pjesë e Planit të ri Kombëtar të Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) 2022-2024

12-17.01.2023: Partneriteti për Qeverisje të Hapur (en. OGP) për Shqipërinë po fillon një fazë të re zhvillimi përmes hartimit të Planit të ri Kombëtar të Veprimit, 2022-2024. Ministria e Drejtësisë do të jetë e përfshirë në këtë dokument me angazhimet kryesore të veprimtarisë së saj, drejtësia dhe antikorrupsioni. Përkatesisht, edukimi dhe ndërgjegjësimi publik për mekanizmat e luftës kundër korrupsionit dhe të aksesit në drejtësi, do të përbëjnë angazhimin prioritar të dakordësuar me institucionet të tjera publike dhe me organizata të shoqërisë civile gjithashtu. Për këtë qëllim, për të garantuar një bashkë-bërje të dokumentit me partnerë jashtë qeverisë, u shpërnda një sondazh publik me propozime për angazhime, por edhe për të marrë propozime të reja mbi rolin bashkëpunues të organizatave në këtë plan veprimi. Gjithashtu, gjatë muajit janar u zhvilluan dy takime pune të dedikuara për diskutimin e masave prioritare. Ky proces i rëndësishëm drejt standarteve më të mira, përfshiu fakultetet e drejtësisë së universiteteve shtetërore dhe private, akademikë dhe profesorë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre me lidhje direkte në sistemin ligjor, qendra studimore, shoqata që merren me vëzhgimin e veprimtarisë së institucioneve shtetërore. Në përfundim të takimeve konsultative, u dakordësua masa prioritare e Planit të Veprimit, referuar ndërgjegjësimin dhe edukimit të publikut të gjerë mbi mekanizmat e aksesit në drejtësi dhe të denoncimit të korrupsionit. Në vijim, hartimi i planit të veprimit do të vijojë me konceptimin edhe konsultimin e masave konkrete për arritjen e rezultateve të pritshme të këtij plani veprimi. Na ndiqni në këtë proces bashkëpunimi!



Më shumë informacion mund të gjeni në link: https://www.drejtësia.gov.al/publikohet-pyetesori-per-bashke-berjen-e-planit-kombetar-te-veprimit-2022-2024-te-partneritetit-per-qeverisje-te-hapur/


Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit dhe Shkolla e Magjistraturës partnerë në luftën kundër korrupsionit

18.01.2023: Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit dhe Shkolla e Magjistraturës lidhën marrëveshje bashkëpunimi për trajnimin e vazhdueshëm të Koordinatorëve Kundër Korrupsionit. Të dy institucionet do të bashkërendojnë veprimtarinë e tyre me qëllim formimin vazhdueshëm të koordinatorëve antikorrupsion, për të përmirësuar dhe garantuar aftësitë profesionale të tyre, në shqyrtimin e rasteve të korrupsionit dhe shpërdorimit të detyrës, si dhe kryerjen e hetimeve administrative brenda fushës së përgjegjësisë të institucionit. Shkolla e Magjistraturës do të bëjë pjesë të kurrikulës së saj të trajnimit edhe këtë rrjet profesionistësh për të mundur sigurimin e angazhimit profesional dhe etik të tyre, në detyrë. Marrëveshja u nënshkrua në Ministrinë e Drejtësisë nga drejtuesit e të dy institucioneve, Ministri i Drejtësisë z. Ulsi Manja dhe drejtori i Shkollës së Magjistraturës, z. Arben Rakipi. Marrëveshja do të fillojë zbatimin menjëherë, dhe në muajin shkurt 2023 do të jete edhe sesioni i parë i trajnimit që do të zhvillohet në kuadër të saj.

Më shumë informacion mund të gjeni në link: https://www.facebook.com/drejtësia.gov.al

Shqipëria fiton 9 vende në renditjen globale të Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit 2022, të Transparency International

31.01.2023: Forcimi i shtetit të së drejtës dhe puna e institucioneve publike drejt promovimit të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit kanë qenë në fokusin e shtetit shqiptar gjatë vitit 2022, arritje të cilat janë vlerësuar edhe nga Transparency International. Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) 2022, rendit 180 vende dhe territore sipas niveleve të perceptuara të korrupsionit në sektorin publik, mbështetur në opinionet e ekspertëve dhe njerëzve të biznesit. Indeksi 2022 analizon lidhjen midis konfliktit, sigurisë dhe korrupsionit, duke kryer një vështrim të thellë se si dhuna dhe korrupsioni ndikojnë njëri-tjetrin në mbarë botën. Sondazhi i këtij viti, vijon të krahasojë nivelet e korrupsionit me kalimin e kohës, duke theksuar se cilat vende janë përmirësuar dhe/apo kanë bërë regres. Sipas Transparency International, për vitin 2022, Shqipëria renditet në vendin e 101 me 36 pikë, duke fituar 1 pikë më shumë se mesatarja e rajonit (35 pikë) dhe ngjitur me 9 vende në renditjen globale. Shqipëria vlerësohet se ka bërë progres në një sërë sektorësh kyç, sikundër është reforma në drejtësi, forcimi i qasjes ndëshkuese dhe arritjet e SPAK,



rritja e fuqisë së shtetit kundër grupeve informale, mafias dhe grupeve kriminale, ndërtimi i mekanizmave për koordinimin e politikave nëpërmjet akteve, shërbimit online, transparencës dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, çka ka ndikuar pozitivisht në përmirësimin e perceptimit publik mbi korrupsionin në vend. Por, Shqipëria duhet të bëjë më shumë për pavarësinë e medias dhe rritjen e ndikimit të organizatave të shoqërisë civile në vendimmarrje.

Më shumë informacion mund të gjeni në link: https://images.transparencycdn.org/images/Report_CPI2022_English.pdf

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit boton fjalorin me termat antikorrupsion

15.01.2023: Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit hartoi dhe publikoi fjalorin e ri “antikorrupsion”, një përmbledhje e dedikuar e referencave gjuhësore të përdorura kryesisht në fushën e antikorrupsionit. Botimi fjalor u përgatit me mbështetjen e asistencës teknike të dhënë nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë dhe synon të shërbejë si një referencë e shpejtë dhe e besueshme jo vetëm për punonjësit e sektorit publik dhe politikëbërësit, por edhe për individët jashtë sektorit publik, siç janë komuniteti i biznesit, organizatat e shoqërisë civile dhe media, me qëllim forcimin e njohurive ndaj simptomave, shkaqeve dhe efekteve të korrupsionit si dhe të strategjive të suksesshme për kundërveprimin dhe parandalimin e korrupsionit. Botimi fjalor “antikorrupsion” është ndërtuar kryesisht në materiale nga Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit, e Këshillit të Europës, *Transparency International*, Qendrës së Burimeve Kundër Korrupsionit U4 dhe burimeve të tjera. Fjalori antikorrupsion do të ofrojë shpjegimet bazë të termave që lidhen me korrupsionin dhe luftën kundër tij si dhe të shërbejë si një manual i mirë për praktikuesit e ligjit dhe studiuesit e të drejtës, për të patur referenca të sakta leksikore dhe zhvilluar shprehje të reja gjuhësore antikorrupsion.

Më shumë informacion mund të gjeni në link:

https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/12/Fjalori_Antikorrupsion_AL.pdf

Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit interaktivitet në rrjetet sociale të komunikimit

1-31.01.2023: Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë, ka rritur bashkëpunimin dhe interaktivitetin e saj me qytetarët nëpërmjet përdorimit të rrjeteve sociale. Profili i Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit në Facebook, Twitter dhe LinkedIn njofton në mënyrë të rregullt e të përditshme aktivitetin e saj rregullator, funksional dhe bashkëpunues, raporton për masat antikorrupsion dhe angazhimet me qëllim afrimin me grupe interesi siç mund të jenë përdoruesit e rrjeteve sociale. Organizata të Shoqërisë Civile, komuniteti i biznesit, akademia, studentë, shkolla, media, qytetarë dhe individë të interesuar mund t’i drejtohen profit të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit dhe të marrin aty informacionin e parë dhe të vendosin urën e bashkëpunimit. Në këtë mënyrë kjo drejtori plotëson edhe një prej rekomandimeve për më shumë bashkëpunim dhe transparencë të shtuar për publikun në luftën kundër korrupsionit. Rekrutime të reja, mekanizma për të denoncuar korrupsionin, publikim të akteve dhe planifikimit strategjik apo edhe raporte ndërkombëtare janë fusha e komunikimit. Mos hezitoni të bashkoheni dhe të ndiqni Drejtorinë e Përgjithshme të Antikorrupsionit në <https://www.facebook.com/profile.php?id=10008904584623> ; <https://twitter.com/DrejtorijaAK>; <https://www.linkedin.com/company/88693364/admin/>.



Bulevardi “Zog I-rë”, Tiranë



<http://www.drejtesia.gov.al>



infoak@drejtesia.gov.al

